Qëllimi kryesor i këtij studimi është roli, rëndësia e auditimit si dhe ndikimi i procesit të AB dhe AJ, në ngritjen e efikasitetit të nderrmarrjes. Qëllimi i këtij kërkimi është shtyrë që nga puna e përditshme që bëjmë duke audituar kompani private, publike, organizata qeveritare dhe jo qeveritare, duke arritur në përfundim se puna kërkimore në këtë fushë është në interes për publikun e gjërë. Qëllimi i kësaj pune kërkimore është të rekomandojë veprime që e zhvillojnë më tej këtë profesion të audituesit duke ndjekur dhe zbuluar standardet ndërkombëtare të auditimit. Kompanitë duhet të organizojnë funksionimin e AB Brenda njësis ekonomike si dhe të angazhojnë AJ për të rritur besueshmërinë e raportimit financiar dhe efektivitetin e funksionimit të sistemeve të brendshme të tyre. Gjatë kërkimit dhe zhvillimit të këtij studimi vura re se kompanitë bëjnë gabime dhe përpiqen të bëjnë mashtrime. Auditimi është një proces që ofron siguri dhe është parandalues për veprimin e gabuar. Qëllimi i kërkimit është vlerësimi i rolit dhe rëndësisë së auditimit në ngritjen e efikasitetit të kompanive si publike ashtu edhe private,

por në rastin tonë vetem të atyre publike. Auditimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin më të mirë të kompanitë si publike ashtu edhe private, nëse funksionon auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm, kanë efikasitet të sistemit Brenda tyre. Kompanitë që e kanë të organizuar sistemin e auditimit kanë më pak gjetje dhe rekomandive të audituesit, ndërsa kompanite që nuk e kanë të organiuar sistemin e auditimit kanë më shumë gabime dhe mashtrime, ku raportimet financiare nuk janë të bësueshme sepse ato nuk u janë nënshtruar kontrolleve. Gjatë studimit vura re që kompanitë që kanë një system të auditimit kanë më pak denime nga administrate tatimore dhe institucionet tjera shtetërore. Shumë kompani që e funksionalizojnë sistemin e auditimit janë t kënaqura me rezultatet e tij. Si drejtimi ashtu edhe përdoruesit e pasqyrave financiare e shohin efektin e auditimit si funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm të proceseve të biznesit që kontrollohen në mënyrë më rigoroze ku edhe procesi funksionon me efikasitet. Hyrja në fuqi e ligjeve mbi raportimin financiar, ku kompanitë duhet të raportojnë sipas Standardeve Nderkombëtare të Auditimit, po luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin efektiv të kompanive. Gjithashtu auditimi ndihmon drejtimin në menaxhim me efektiv të aktiviteteve të njësi ekonomike.

Në mbështetje të këtij qëllimi janë vendosur objektivat e mëposhtme:

- Së pari, njohja me konceptet kryesore të auditimit si concept
- Së dyti, shqyrtimi i literatures në lidhje me AB dhe AJ, SNA si dhe sfida e audituesit në ekonominë globale
- Së treti, shqyrtimi i literaurës në lidhje me zhvillimin e Auditimit
- Së katërti, njohja me metodologjinë që do të përdoret gjatë këtij studimi
- Së pesti, studimi i raporteve të PF të ndërmarrjeve publike si dhe organizatat buxhetore
- Së gjashti, dhënja e disa konkluzioneve në lidhje me procesin e auditimit dhe faktorët që ndikojnë në ngritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve
- Së shtati, dhënja e rekomandimeve për studime të tjera në këtë fushë.

Kufizimet e studimit

Krahas vlerës dhe rëndësis që mundohet të ketë ky punim vlenë të theksohen edhe disa kufizime të cilat mund të ndikojnë në rezultatet e nxjerra. Fillimisht duhet të theksojmë se gjatë gjithë procesit të këtij kërkimi kam qenë mjaft e kujdesshme në lidhje me arritjen e përfundimeve të vlefshme e sidomos për përgjithësimin e tyre.

Ky studim mbart këto kufizime:

- a) Mungesa e studimeve të ngjashme të kësaj fushe në vendin tonë, kufizon mundësinë krahasimtare të rezultateve
- b) Vështirësitë në lidhje me gjetjen e informacionit
- c) Hezitimi i ndërmarrjeve për të dhënë informacione
- d) Numri i vogël i ndërmarrjeve që kanë audituar PF
- e) Burokraci në ndërmarrjet publike për të investuar personat me pozitë të lartë menaxheriale

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

Standardet ndërkombëtare të auditimit janë udhërrëfytes për veprimin e audituesve. Standardet rregullojnë punën e audituesit ku audituesi duhet ti respektojë këto standarde. Standardet ndërkombëtare të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm paraqesin se si audituesi duhet të veprojë. AJ dhe AB kryhet në mjedise të ndryshme ligjore dhe kulturore: brenda organizatave që ndryshojnë për nga qëllimi, madhësia, kompleksiteti dhe sturkturat të cilat veprojnë nga persona brenda apo jasht orgnaizatës. Qëllimi i standardeve është:

1. Të përshkruaj parimet bazë që përfaqësojnë praktikën e auditimit.
2. Të japë një kuadër për kryerjen dhe promovimin e një game të gjërë të AJ dhe AB për të shtuar vlerë.
3. Të vendosë bazën për vlerësimin e përformancës së auditimit.
4. Të nxisë përmirsimin e proceseve organizative dhe të operacioneve.
- 5.

Standardet janë të fokusuara në parime dhe kërkesa të detyrueshme që përbëhen nga:

- Deklaratat e kërkesave themelore për praktikën profesionale të auditimit si dhe për vlerësimin e efektivitetit të ërformancës, të cilat janë të zbatueshme në nivel organizativ dhe individual.
- Interpretimet, të cilat sqarojnë temat apo konceptet që përmbajnë këto deklarata.

Aplikimi i standardeve të auditimit të brendshëm

Aktiviteti I AB është në përputhje me standardet ku arrin rezultatet e përshkruara në përkufizimin e auditimit të brendshëm, kodin e etikës dhe standardet. Rezultatet e programit të siguridhënjes dhe përmirsimit të cilësis përfshijnë rezultatet e të dy vlersimeve, vlerësimin të brendshëm dhe atij të jashtëm⁵. Të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm do të kenë rezultate të vlersimeve të brendshme. Aktivitetet e AB të kryera për një periudhë të paktën prej pesë vitesh do të kenë gjithashtu rezultatet e vlersimeve të jashtme.⁶ Aktiviteti I AB drejtohet në mënyrë efektive kur:

- Rezultatet e punës së aktivitetit të AB permbushin qëllimin dhe përgjegjësitë e përfshira në statutin e auditimit të brendshëm;
- Aktiviteti I auditimit të brendshëm është në përputhje me përkufizimin e AB dhe me standardet;
- Individët, të cilët janë pjesë e aktivitetit të AB, tregojnë se veprojnë në përputhje me kodin e etikës dhe standardet.

Drejtuesi I auditimit të brendshëm duhet ti raportojë periodikisht menaxhimit të lartë dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatet e aktivitetit të AB në raport me planin e tij.

⁵ Prof.As.Dr. Skender Kërçuku, Auditimi, Tiranë, 2012

⁶ 81321 – Përdorimi i deklaramit “Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm”

Raportimi duhet të përfshijë ekspozime ndaj rreikut material dhe qështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, qështjet e qeverisjes së organizatës dhe qështjet e tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi.⁷ Janë bërë vlerësime periodike për të vlerësuar përputhshmëri me kodin e etikës dhe standardet. Njohuri të mjaftueshme të praktikave të auditimit të brendshëm kërkojnë të paktën një kuptim të të gjitha elementeve të kornizës ndërkombëtare të praktikës profesionale.⁸

Roli i audituesit të brendshëm në zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit

Mos zbulimi i mashtrimeve ndikon shumë në entitet sikurse doktori që nuk e zbulon sëmundjen dhe mund të ketë pasoja për njeriun, edhe audituesit duhet të jetë një doktor i aftë të zbulojë mashtrimet sepse kompania mund të vdesë sikurse njeriu. Hapsira shtrirëse e tyre varet nga gjykimet e auditorit në lidhje me:

- Llojin e mashtrimit apo gabimit
- Gjasat për shfaqjen e tyre
- Gjasat për ndikim material në pasqyrat financiare.⁹

Në vitet 1993, 1994 dhe 1998 Divizioni i shërbimeve hetimore i frimës së pavarur të kontabilitetit të KPMG, ka kryer një studim të gjërë për mashtrimet nga një rrjet i gjërë i bizneseve dhe industrive (KPMG 1994,1995,1999). Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë më tej këtë paradox duke nxjerrë mendimet dhe qëndrimet e audituesve të brendshëm për rolin e tyre në parandalimin e mashtrimit dhe zbulimin e tyre. Të anketuarit në vitin 1998 treguan se 62 për qind e këtyre subjekteve kanë përjetuar të paktën një lloj të mashtrimit në vitë. Pesëdhjetë e nëntë për qind besonin se mashtrimi do të bëhet një problem në të ardhmen duke rritur presionin ekonomik, për shkak të dënimit të pamjaftueshëm të dënuarve, dhe theksit të pamjaftueshëm për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve (KPMG 1999). Sipas standardeve për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, audituesit e brendshëm duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për të identifikuar treguesit e mashtrimit (IIA, 2001). IIA pranon rëndësinë e përfshirjes së audituesit të brendshëm në procesin e zbulimit dhe parandalimit të mashtrimit. Në

⁷ 2060 – Raportimi në Menaxhimin e Lartë dhe në Bord

⁸ Standardi 1311 - Vlerësimet e Brendshme IIA 2017

⁹ Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të Kosovës, "Hyrje në Auditim", fq 51

zbulimin e mashtrimeve dhe parandalimin e tyre në standardet e auditimit të brendshëm, sipas studimit KPMG, funksioni I auditimit të brendshëm është I përfshirë në zbulimin e rreth 43 përqind të mashtrimeve të raportuara në vitin 1998, ndërsa funksioni I auditimit të jashtëm (I dizajnuar me qëllim të zbulimit të anomalive të shkaktuara pjesërisht për shkak të mashtrimit), ishte I përfshirë në zbulimin e vetëm katër përqind të mashtrimeve të raportuara (KPMG, 1999). Deri në vitin 2001, parandalimi dhe zbulimi I mashtrimit ishin qëllim I përbashkët si për audituesit e brendshëm dhe të jashtëm. Të dy grupet do të bëjnë përpjekje për bashkëpunim më të madhë, si dhe për të nxjerrë me shkrim standard specifike të drejtuara këtij qëllimi. Shtrohet pyetja: kush mund të ofrojë shërbime të auditimit? Auditor mund të jetë, person I zakonshëm, firmë e auditorëve dhe pastaj raporti i auditorit duhet të nënshkruhet nga një individ i kualifikuar.¹⁰

Përkufizimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

Kontrolli I brendshëm është një proces I kryer nga organi mbikqyrës I një njesie ekonomike, menaxhimi dhe personeli të cilët ofojnë siguri të arsyeshme se objektivat e një njesie do të arrihen. Këto objektiva dhe risqet e lidhura me to mund të klasifikohen gjerësisht në një ose më shumë nga tri kategoritë e mëposhtme:

- Operacionet – Efikasiteti dhe efienca e operacioneve
- Raportimi – Besueshmëria e raportimit për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm
- Pajtueshmëria – Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret në fuqi

Këto janë kategori të dallueshme, por mbivendosëse. Një objektiv I veçant mund të përfshihet në më shumë se një kategori, mund ti përgjigjet nevojave të ndryshme dhe mund të jetë përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e individëve të ndryshme. Kontrolli I brendshëm përfshin planet, metodat, politikat dhe procedurat e përdorura për të përmbushur misionin, planin strategjik, qëllimet dhe objektivat e subjektit. Një system I kontrollit të brendshëm është një komponent I vazhdueshëm, I inkorporuar I veprimeve të kryera nga njerëzit që ofron siguri të arsyeshme, jo absolute që objektivat e një njesie do të arrihen. Kontrolli I brendshëm nuk është një ngjarje, por një seri veprimesh që ndodhin gjatë gjithë veprimtarisë së një njesie ekonomike.

¹⁰ Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi, "Auditimi", Prishtinë 2012, fq 213

Kontrolli I brendshëm njihet si një pjesë integrale e përdorimit të menaxhimit të proceseve operacionale për të udhëhequr operacionet e tij në vend të një sistemi të veçantë brenda një njesie ekonomike. Në këtë kuptim, kontrolli I brendshëm është ndërtuar në njësi si pjesë e organizimit të një structure për të ndihmuar menaxhimin të arrijë objektivat e njesisë së një baze të vazhdueshme. Njerëzit janë ata që bëjnë punën e kontrollit të brendshëm. Si pjesë e kësaj përgjegjësie, menaxhimi I përcakton objektivat e subjektit, zbaton kontrollet dhe vlerëson sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, personeli në të gjithë njësinë ekonomike luan një rol të rëndësishëm. Një system efektiv I KB rrit gjasat që një njesi ekonomike të arrijë objektivat e saj. Megjithatë, pavarësisht se sa mirë është projektuar, zbatuar ose operuar, një system I KB nuk mund të sigurojë aiguri absolute se të gjitha objektivat e një organizate do të përmbushen. Faktoret jasht kontrollit ose ndikimit të menaxhimit mund të aplikojnë në aftësinë e njësisë për të arritur të gjitha objektivat e saj¹¹.

Krijimi I një sistemi Efektiv të Kontrollit të brendshëm

Një njesi përcakton misionin e saj, vendos një plan strategjik, përcakton objektivat e njesis dhe formulon planet për arritjen e objektivave të saj. Menaxhimi me mbikqyrje nga organi mbikqyrës I njesis ekonomike, mund të përcaktojë objektiva për një njesi ekonomike si tërësi ose për të synuar aktivitetet brenda njesis ekonomike. Menaxhimi përdor kontrollin e brendshëm për të ndihmuar organizatën që të arrijë këto objektiva. Ndonëse ka mënyra të ndryshme për të paraqitur kontrollin e brendshëm, Libri I Gjelbër I afrohet kontrollit të brendshëm nëpërmjet një structure hierarkike prej pesë komponentësh dhe 17 parimesh. Hierarkia përfshin kërkesat për krijimin e një KB efektiv, duke përfshirë kërkesat specifike të dokumentacionit. Pesë përbërësit përfaqësojnë nivelin më të lartë të hierarkisë së stndardeve për kontrollin e brendshëm në qeverinë federale. Pesë komponentët e kontrollit të brendshëm duhet të jenë në mënyrë efektive të projektuar, zbatuar dhe operuar dhe të veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv. Pesë komponentët e KB janë si më posht:


- **Mjedisi i kontrollit-** Themeli I një sistemi të KB. Ai siguron disiplinën dhe strukturën për të ndihmuar një njesi ekonomike për të arritur objektivat e saj.

¹¹ Shefket Jakupi, Hidajet Shehu, "Kontrolli dhe revizioni i proceseve afrariste në ndërmarrje", Prishtinë 2011, fq.17

- **Vlerësimi i rrezikut-** vlerëson risqet me të cilat ballafaqohet njesia e cila synon të arrijë objektivat e tij. Ky vlerësim siguron bazën për zhvillimin e përgjigjeve të duhura ndaj rrishtit.
- **Aktivite e kontrollit-** menaxhimi i veprimeve nëpërmjet politikave dhe procedurave krijon arrijtjen e objektivave dhe përgjigjen ndaj risqeve në sistemin e kontrollit të brendshëm i cili përfshin sistemin informativ të njesitë.
- **Informimi dhe komunikimi-** menaxhimi i informacionit cilësor nëpërmjet të cilit personeli komunikon dhe përdor për të mbështetur sistemin e KB.
- **Monitorimi-** menaxhimi i aktiviteteve themlon dhe vepron për të vlerësuar cilësinë e performancës me kalimin e kohës dhe për të zgjidhur menjëherë gjetjet e auditimeve dhe inspektimeve të tjera.¹²

Figura 3. Komponentët e KB

¹² Public Internal Financial Control. Evidence from Albania, Almida Kafia, 2015



Burimi: <http://www.finac.org.rs/>

Në përgjithësi, të gjithë komponentët dhe parimet janë relevante për krijimin e një sistemi efektiv të KB. Në rrethana të rralla, mund të ketë një situatë operative ose rregullator në të cilën menaxhimi ka përcaktuar që një parim nuk është relevant për njësinë për të arritur objektivat e tij dhe për të adresuar rrizqet që lidhen me të. Nëse menaxhimi përcakton që një parim nuk është relevant, ai e mbështet atë përcaktim me domunetacion që përfshinë arsyetimin se sin ë mungesë të këtij parimi komponenti I lidhur mund të projektohet, zbatohet dhe operatohet në mënyrë efektive. Përveq kërkesave parësore, Libri i Gjelbër përmban edhe kërkesat e dokumentacioneve.¹³

¹³ Standardet e Kontrollit të Brendshëm në Zyrën e Auditimit të Qeverisë, Tiranë 2018

Perfundimi

Ato ndërmarrje në të cilat funksionon auditimi I brendshëm kanë më pak gjetje dhe rekomandime nga audituesit si rrjedhojë edhe pasqyrat financiare janë më të besueshme dhe ka më pak gabime dhe mashtrime.

Ato ndërmarrje që ju funksionon auditimit I brendshëm kanë efikasitet më të lartë.

Kontabilistët dhe audituesit duhet të jenë të përgaditur profesionalisht për të plotësuar nevojat e klientëve të tyre.

Auditimi I brendshëm është një proces I verifikimit për të reduktuar mashtrimet dhe gabimet brenda kompanisë.

Audituesi duhet të jetë një person me shumë përgjegjësi I cili vendimet duhet ti mere në bazë të njohurive profesionale, eksperiencës dhe trajnimeve që ka kryer.

Dikush duhet të kalojë përmes një baze me të gjërë përvojash teknike ashtu edhe të sjelljes për të qenë efektiv në funksionin veqanarisht në sektorin publik ku kontrollet janë ende të dobëta dhe pritjet e publikut janë jashtëzakonisht të mëdha.

Nëse audituesi I parandjenë mashtrimet ai si profesionalist që është duhet të investigojë edhe më shumë në lidhje me to e asesi të tërhiqet. Besimi është I mirë po kontrolli është akoma edhe më I mirë.

Auditimi si proces rrit besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe me rritjen e besueshmërisë rritet edhe bashkëpunimi në mes partnerëve siq janë investitorët, kreditorët etj.

Auditimi është një gjenerator I zhvillimit të ndërmarrjeve.

Drejtimi dhe përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare e shohin ndikimin e auditimit nëpërmjet funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm dhe proceseve tjera brenda ndërmarrjes.

Auditimi I brendshëm ofron siguri objektive I cili është I dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës.

Ndryshimet e shpejta në natyrën e biznesit kanë sjellë nevojën për siguri dhe kontroll të vazhdueshëm për të parandaluar rreziqet që mund ti kanosen kompanisë.

Përgjegjësia e audituesit është që të tregojë se sa menaxhimi ka prezantuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë informacionin në pasqyrat financiare.

Një funksion i kontrolluar i auditimit të brendshëm mund të luajë një rol jetësor në procesin e qeverisjes dhe llogaridhënjes së institucioneve të sektorit publik.

Organet drejtuese dhe menaxhmenti në sektorin publik kanë nevojë që shprehjet e auditimit të brendshëm të jenë efektive dhe efikase.

Legjitimiteti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe misioni i tij duhet të kuptohet dhe të mbështetet nga menaxhmenti i lartë i subjekteve qeveritare për të rritur efektivitetin e tij në promovimin e qeverisjes së mirë, kontrollit dhe sistemeve të menaxhimit të rrezikut në sistemin publik.

Referencat

Internal Auditing in the Public Sector, Thomas Asare, 2009

Roli dhe rëndësia e auditimit në ngritje të efikasitetit në ndërmarrje, Fatmir Mehmeti, 2018

Factors that Contribute to the Effectiveness of Internal Audit in Public Sector

<https://pdfs.semanticscholar.org>

Internal Audit Types, University Audit Services, 2018

Revizija i Kontrola 2012 Doc. dr Milanka Aleksić

INTERNAL CONTROL AND AUDIT AT LOCAL LEVELS <http://documents.worldbank.org>

Raporti ROSC Kosovo 2012

Prof.As.Dr. Skender Kërquku, Auditimi, Tiranë, 2012

81321 – Përdorimi i deklaramit “Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm”

2060 – Raportimi në Menaxhimin e Lartë dhe në Bord

Standardi 1311 - Vlerësimet e Brendshme IIA 2017

REMITTANCES - IMPORTANCE AND EFFECT IN THE ECONOMY - THE CASE OF KOSOVO

Dr.sc. Agim BERISHA

Kolegji Biznesi, Fakulteti Ekonomik

email: agim.berisha74@hotmail.com

Abstract: Remittances sent by the Kosovo Diaspora have been and remain an important source of income for households in Kosovo. The paper addresses issues related to the remittances of the Kosovar diaspora, including the analysis of their economic effect before and during Covid19.

In different periods, remittances from the diaspora have played an important role in economic terms, especially remain an important source of finance for the household in Kosovo. Given that Kosovo after the last war, remains among the countries with low level of development and high unemployment, the importance and economic effect of remittances of the Kosovar diaspora has been and remains of particular importance, affecting consumption and well-being of families in Kosovo. Diaspora plays an important role in Kosovo's economy by sending remittances, presenting an important potential not only for households but also for Kosovo's economy in general. For sending their means, the diaspora uses different ways, which are generally formal and informal ways of sending money.

Key concepts: Remittances, GDP, Kosovo diaspora, Covid19, formal and informal routes.

REMITANCAT- RËNDËSIA DHE EFEKTI NË EKONOMI- RASTI I KOSOVËS

Dr.sc. Agim BERISHA

Kolegji Biznesi, Fakulteti Ekonomik

email: agim.berisha74@hotmail.com

Abstrakt: Remitencat e dërguara nga diaspora e Kosovës kanë qenë dhe mbeten një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet në Kosovë. Punimi trajton çështjet që kanë të bëjnë me remitencat e diasporës kosovare, duke përfshirë analizën e efektit të tyre ekonomik para dhe gjatë Covid19.

Në periudha të ndryshme, remitencat nga diaspora kanë luajtur një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik, veçanërisht mbeten një burim i rëndësishëm financimi për ekonomitë familjare në Kosovë. Duke qenë se Kosova pas luftës së fundit, mbetet ndër vendet me nivel të ulët të zhvillimit dhe papunësi të lartë, rëndësia e veçantë dhe efekti ekonomik i remitencave të diasporës kosovare ka qenë dhe mbetet i një rëndësie të veçantë, duke ndikuar në konsumin dhe mirëqenien e familjeve në Kosova.

Diaspora luan rol të rëndësishëm në ekonomin e Kosovës përmes dërgimit të remitencave duke paraqitur një potencial të rëndësishëm jo vetëm për ekonominë familjare por edhe në përgjithësi për ekonominë e Kosovës. Për dërgimin e mjeteve të tyre diaspora shfrytëzon rrugë të ndryshme që në përgjithësi janë rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave.

Konceptet kryesore: Remitancat, BPV, diaspora e Kosovës, Covid19, rrugë formale dhe joformale.

1.Hyrja

Në kuadër të punimit trajtohen çështje të cilat kanë të bëjnë me remitencat e diasporës kosovare, rëndësinë e tyre për ekonominë familjare në Kosovë, format e dërgimit dhe efekti ekonomik para dhe gjatë Pandemisë Covid 19. Diaspora Kosovare është e shpërndarë në shtete të ndryshme, pjesa më e madhe e tyre janë të përqendruar në vendet e Evropës Perëndimore. Remitencat nga diaspora padyshim mbesin një burim i rëndësishëm i financave për ekonominë familjare në Kosovë. Dërgimi i mjeteve financiare nga diaspora në Kosovë vijnë përmes rrugëve të ndryshme që në përgjithësi përdoren rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave.

Marr parasysh nivelin e ulët zhvillimor në vend, shkallën e lartë të papunësisë, deficitin në bilancin tregtar, rëndësia dhe efekti ekonomik i remitencave të diasporës kosovare ka qenë dhe mbetet i një rëndësie të veçantë kryesisht në konsumin dhe mirëqenien e familjeve pranuese në Kosovë. Në këtë punim objektivat kryesore konsistojnë në:

- Analizën e ecurisë së remitencave viteve të fundit në Kosovë.
- Analiza e rëndësisë dhe efekti ekonomik i remitencave në Kosovë.

2.Metodologjia e përdorur

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje përfshirë literaturën shkencore, si dhe raporte e publikime nga Banka Qendrore e Kosovës, ku trajtohen çështje të lidhura me remitencat, përkatësisht ndikimi dhe efekti ekonomik i remitencave në Kosovë para dhe gjatë Pandemisë Covid19. Po ashtu është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

3.Rishikimi i literaturës

Për shumë kosovarë kushtet e pafavorshme politike dhe ekonomike ishin nxitje për emigrim në vendet e tjera. Emigrimi nga Kosova ka filluar në fund të viteve të 60-ta dhe fillim të viteve të 70-ta dhe mund të ndahet në katër faza:¹⁴

- 1) 1960-1988;
- 2) 1989-1997;

¹⁴ Instituti Riinvest (2007). Diaspora dhe politikat e migracionit, Prishtinë, fq, 27.

- 3) Grupi i refugjatëve të luftës së vitit 1998-99 dhe
- 4) 2000---

Shumica e emigrantëve janë të koncentruar në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet tjera më të zhvilluara të Evropës e Botës. Dërgesat e emigrantëve kanë ndikim në proceset ekonomike dhe shoqërore në Kosovë, veçmas në vlerën e konsumit të popullsisë.¹⁵

Diaspora luan rol shumë të madh në zhvillimin ekonomik të Kosovës, nëpërmjet kontributit material (remitencave) dhe formave të ndihmave tjera.¹⁶ Diaspora paraqet një potencial të rëndësishëm dhe faktorë mbështetës të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës në të ardhmen. Për dërgimin e mjeteve të tyre emigrantët shfrytëzojnë rrugë të ndryshme që në përgjithësi ndahen në dy grupe kryesore:¹⁷ rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave. Gjatë transferit përmes kanaleve jozyrtare emigrantët kanë shfrytëzuar dy rrugë kryesore: i kanë dërguar mjetet vet personalisht gjatë vizitave në vendlindje, apo mënyra tjetër përmes të afërmeve e miqve të tyre.¹⁸

4.Rezultate dhe diskutime

Remitencat nga jashtë konsiderohen kontribuues i rëndësishëm për mirëqenien e familjeve kosovare. Remitencat paraqesin burim të rëndësishëm të investimeve private dhe përbëjnë element shumë të rëndësishëm të kërkesës agregate, sepse ndikojnë në rritjen e konsumit.

Me fjalë tjera, duke mos u përqendruar në analizë komplekse empirike, përfshirë rëndësinë dhe efektet e remitencave në ekonomin e Kosovës, në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e remitencave në periudhën 2007-2021.

Tabela 1:

Ecuria e remitencave të dërguara në Kosovë në periudhën 2007-2021

-në milionë

Vitet	Remitencat (dërgesat e diasporës)
2007	588.5
2008	608.1
2009	585.7
2010	584.3
2011	492.5
2012	516.4
2013	573.4
2014	622.3
2015	655.5

¹⁵ Limani, Musa (2013). Makroekonomia, Prishtinë, fq, 222.

¹⁶ Limani, Musa (2018). Ekonomia e Kosovës, Prishtinë, fq, 335.

¹⁷ Banka Qendrore e Kosovës (2013). Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitencave në Kosovë, Prishtinë, fq, 19.

¹⁸ Po aty, fq, 23.

2016	691.0
2017	759.2
2018	800.6
2019	851.7
2020	980.0
2021	1,153.4

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujor Statistikor Nr. 248, Prishtinë, 2022, fq. 96.




Figura 1: Ecuria e remitencave të dërguara në Kosovë në periudhën 2007-2021

Nga tabela dhe grafiku vërehet ecuria e remitencave të dërguara në Kosovë përfshirë periudhën 2007-2021. Në vitin 2007 remitencat e dërguara në Kosovë ishin në vlerë prej 588.5 milionë euro, duke pasur ecuri të rënies në vitin 2011, ndërsa viteve në vijim ecuri të rritjes duke arritur në vitin 2021 në vlerë prej 1.1 miliardë euro.

Remitencat dhe efekti në ekonomi në Kosovë

Kapitali i diasporës ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në burimet financiare të popullsisë së Kosovës, pasi një pjesë të kursimeve të tyre ua dërgojnë familjarëve të tyre në Kosovë. Remitencat paraqesin burim shumë të rëndësishëm të të hyrave të popullsisë së Kosovës. Remitencat në Kosovë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë nga të cilat sigurojnë një pjesë të madhe të konsumit final. Në këtë kuadër, remitencat (dërgesat e parave nga diaspora) paraqesin një vlerë të caktuar të investimeve private duke përbërë një element të

rëndësishëm të kërkesës agregate, sepse ndikojnë në rritjen e konsumit. Padyshim, mërgata kosovare e shpërndarë në vende të ndryshme të botës përmes remitencave (mjeteve financiare) të dërguara familjeve në Kosovë, ndikojnë në rritjen e konsumit dhe standardit jetësor, në zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e problemeve sociale, si dhe përmes investimeve ekonomike në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Pra, diaspora kosovare në periudha të ndryshme ka luajtur rol të rëndësishëm duke siguruar një burim të rëndësishëm të financave për ekonominë e Kosovës. S'ka dyshim që, diaspora ka qenë dhe vazhdon të mbetet një potencial i rëndësishëm dhe mbështetës në zhvillimet në aspektin ekonomik në Kosovë.

Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 4, Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM2 2020, Prishtinë, 2020).

Në tabelën në vijim pasqyrohet Bruto Produkti Vendor-BPV në Kosovë përfshirë periudhën 2019-2021.

Tabela 2:

Bruto Produktit Vendor në Kosovë para pandemisë covid19 dhe gjatë pandemisë covid19

-(000) euro

Vitet	Bruto Produkti Vendor
2019	6,988,873
2020	6,679,352
2021	7,484,502

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 5: Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008-2020, Prishtinë, 2021, fq, 7. Agjencia e Statistikave e Kosovës, Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM1 2022, Prishtinë, 2022, fq,7.




Figura 2: Bruto Produktit Vendor në periudhën e viteve 2019-2020

Nga tabela dhe grafiku, mbi ecurinë e BPV-së, në periudhën e viteve 2019-2021, shihet se vlera e BPV-së ka pasur trend të rënies në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak 2019, kjo si rezultat i masave dhe kufizimeve në ekonomi në periudhën e pandemisë covid19. Gjatë periudhës 2019-2020, Bruto Produkti Vendor ka pasur trend të rënies nga 6.9 miliardë euro sa ishte në vitin 2019, në 6.6 miliardë euro në vitin 2020, ndërsa duke pasur ecuri të rritjes në vitin 2021 duke arritur në vlerë prej 7.4 miliardë euro.

Në tabelën në vijim pasqyrohet norma reale e BPV në Kosovë në periudhën 2019-2021.

Tabela 3:

BPV- Norma reale e rritjes në Kosovë në periudhën 2019- 2021

Vitet	2019				2020				2021			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Norma reale e rritjes së BPV-së %	4.24	4.13	4.38	3.94	0.26	-12.73	-7.73	0.10	4.12	16.77	14.53	6.36

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 4: Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM4 2021, Prishtinë, 2020, fq. 3. Agjencia e Statistikave e Kosovës, Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM1 2022, Prishtinë, 2022, fq. 5.




Figura 3: BPV-Norma reale e rritjes në periudhën 2019-2021.

Ritmi i rritjes së ekonomisë përfaqëson normën me të cilën rritet GDP reale (Rudiger Dornbusch, Stanley Fischer, Makroekonomia, Përkthyer: Dr. Marta Muço, Dr.Sulo Hadëri, Dituria, Tiranë, 2000). Rritja ekonomike nuk arrihet asnjëherë me një koeficient rritës konstant. Në kuadër të tabelës dhe grafikut pasqyrohet trendi i normës së rritjes reale të BPV-së në Kosovë përgjatë periudhës 2019-2020 dhe 2021. Rritja reale e BPV-së në vitin 2019 në TM4 ishte 3.94%, duke pasur rënie në vitin 2020 në TM2 në -12.73% dhe në TM3 në -7.73% kjo si rezultat i masave dhe kufizimeve në ekonomi me fillimin e pandemisë covid19, ndërsa në fund të vitit 2020 dhe në vitin 2021 me heqjen e masave dhe kufizimeve në ekonomi (hapja e ekonomisë) është reflektuar edhe në trendet e rritjes ekonomike duke arritur në TM4 2021 me normë të rritjes të BPV prej 6.36%.

Tabela 4: Remitencat dhe BPV në Kosovë 2019-2021

	Remitencat	BPV	Raporti remitencat/BPV (%)
2019	851,700,000	6,988,873,000	13.0%
2020	980,000,000	6,679,352,000	15.0%
2021	1,153,400,000	7,484,502,000	16.0%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujo Statistikor Nr. 248, Prishtinë, 2022, fq. 96. Agjencia e Statistikave e Kosovës, Statistikat e Llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM1 2022, Prishtinë, 2022, fq. 5.




Figura 4: Raporti remitencat/BPV në Kosovë 2019-2021

Vështruar tabelen dhe grafikun sa i përket raportit remitencat/BPV vërehet, se remitencat kanë një ecuri në rritje të pjesëmarrjes në BPV. Në vitin 2019 pjesëmarrja e remitencave në BPV ishte 13% duke u rritur pjesëmarrja e remitencave në BPV në vitin 2021 në 16%.

Kosova që nga paslufta vazhdon të ketë nivel të ulët të rritjes ekonomike, normë të lartë të papunësisë dhe deficit të lartë tregtar. Marr parasysh këtë tregues, ekonomia e Kosovës veçmas ekonomitë familjare vazhdojnë të kenë varësi në masë të madhe nga remitencat e dërguara nga diaspora kosovare.

Remitencat janë zakonisht të ndjeshme dhe ndikohen ndaj kushteve ekonomike të vendeve nga të cilat ato burojnë, të cilat mund të jenë dobët të lidhura me ngjarjet në shtetin përfitues. Padyshim që, remitencat kanë tendencë të rriten (zvogëlohen) kur kushtet në shtetet përfituese keqësohen (përmirësohen). Me fjalë tjera, vështruar nga aspekti ekonomik remitencat kanë varësi të drejtpërdrejtë ndaj rrjedhave ekonomike dhe kushteve tjera në shtetin përfitues. Pandemia Covid19 e filluar në Kinë në fund të vitit 2019 dhe e cila përfshiu pothuajse të gjitha vendet e botës në fillim të vitit 2020, kështu që edhe Kosova u përfshi nga kjo pandemi duke filluar nga muaji Mars 2020. Nisur nga kjo, Pandemia Covid19 që ka përfshirë botën, padyshim që ka ndikuar në gjendjen financiare të emigrantëve kosovar duke ndikuar drejtpërdrejtë edhe në remitencat (mjetet financiare) të dërguara nga diaspora në Kosovë.

Tabela 5: Remitancat e dërguara në Kosovë para Pandemisë dhe fillimi Pandemisë Covid19

-në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komerciale	Agjencionet për transferim parave	Të tjera
Janar-Shkurt 2020	123.7	14.8	64.1	44.9
Mars-Prill 2020	122.0	16.1	92.7	13.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 224, Prishtinë, fq. 99.




Figura 5: Remitancat e dërguara në Kosovë para Pandemisë dhe gjatë Pandemisë Covid19

Nga tabela dhe grafiku pasqyrohet ecuria e remitencave të dërguara në Kosovë nga diaspora përfshirë periudhën para pandemisë Covid19 dhe fillimin e pandemisë Covid19 në Kosovë. Në periudhën Janar-Shkurt 2020 para fillimit të pandemisë Covid19, shihet se remitencat e dërguara në Kosovë ishin në vlerë prej 123.7 milionë euro, ndërsa në periudhën Mars-Prill 2020 me fillimin e pandemisë Covid19 ishin në vlerë prej 122.0 milionë euro. Krahasuar ecurinë e remitencave të dërguara para dhe gjatë pandemisë Covid19, shihet se në periudhën Mars-Prill 2020 me fillimin e pandemisë Covid19 në Kosovë kishte rënie të lehtë të remitencave të dërguara në Kosovë, krahasuar me periudhën Janar-Shkurt 2020 para fillimit të pandemisë Covid19 në Kosovë.

Tabela 6: Remitancat dhe kanalet e dërgimit për periudhën Janar-Qershor 2019 (para pandemisë) dhe Janar-Qershor 2020 (gjatë pandemisë)

-në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komerçiale	Agjencionet për transferim parave	Të tjera
Janar 2019	56.4	9.0	27.0	20.4
Shkurt 2019	56.6	5.6	30.5	20.5
Mars 2019	71.7	9.1	36.6	26.0
Prill 2019	68.8	9.4	34.5	24.9
Maj 2019	78.4	7.6	42.4	28.4
Qershor 2019	73.5	9.9	37.0	26.6

Janar-Qershor 2019	405.4	50.6	208.0	146.8
Janar-Dhjetor 2019	851.7	123.0	420.1	308.5
Janar- 2020	62.3	10.1	29.6	22.6
Shkurt-2020	63.3	5.9	34.5	22.9
Mars-2020	61.7	7.3	41.2	13.8
Prill 2020	60.3	8.8	51.5	---
Maj 2020	104.0	15.4	88.6	---
Qershor 2020	81.6	11.3	59.0	---
Janar-Qershor 2020	433.2	58.8	304.4	59.3
Janar-Dhjetor 2020	980.0	141.3	672.0	166.6

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 224, Prishtinë, fq. 99.
 Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 226, Prishtinë, fq. 99.
 Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 212, Prishtinë, fq. 99.




Figura 6: Ecuria e remitancave për periudhën Janar-Qershor 2019 dhe Janar-Qershor 2020

Duke analizuar remitencat e dërguara nga Diaspora në Kosovë dhe duke krahasuar periudhën e njëjtë të vitit 2019 me periudhën e vitit 2020, nga tabela Nr.3, pasqyrohet ecuria e remitencave të dërguara në Kosovë për periudhën Janar-Dhjetor 2019 (para pandemisë Covid19) dhe Janar-Dhjetor 2020 (gjatë pandemisë Covid19). Remitencat e dërguara në Kosovë në Periudhën Janar-Qershor 2019 ishin në vlerë prej 405.4 milionë euro, ndërsa në periudhën Janar-Dhjetor 2019 ishin në vlerë 851.7 milionë euro, kurse në periudhën Janar-Qershor 2020 ishin në vlerë prej 433.2 milionë euro dhe periudhën Janar-Dhjetor 2020 ishin në vlerë prej 980.0 milionë euro, duke pasur rritje të remitencave të dërguara në Kosovë. Në vitin 2020, para fillimit të pandemisë Covid19 në Kosovë, gjatë muajve Janar-Shkurt 2020 ka pasur një rritje të remitencave prej 11% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (2019) janar-Shkurt 2019, ndërsa në muajin Mars 2020 pati një rënie të remitencave prej rreth 14%, krahasuar me muajin Mars 2019. Remitencat në muajin Mars 2020 ishin 61.7 milionë euro kundrejt 71.7 milionë euro në muajin Mars 2019. Rënie kjo, që mund të jetë si rezultat i fillimit të pandemisë Covid19 në Kosovë dhe ndikimit të saj në vendet tjera dhe në ekonominë e vendeve ku jetojnë dhe punojnë diaspora Kosovare duke pasur efekt edhe në dërgimin e remitencave nga diaspora në Kosovë në periudhën e fillimit të pandemisë Covid19.

Në Kosovë me vendimit të Qeverisë së Kosovës masat e para emergjente për parandalimin e përhapjes së Pandemisë Covid19 janë marrur në Muajin Mars 2020. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen remitencat e dërguara në Kosovë para Pandemisë (2019) dhe gjatë Pandemisë Covid19 (2020 dhe 2021).

Tabela 7: Remitancat dhe kanalet e dërgimit para dhe gjatë pandemisë Covid19

-në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komerçiale	Agjencitë për transferimin e parave	Të tjera
2019	851.7	123.0	420.1	308.5
2020	980.0	141.3	672.0	166.6
2021	1,153.4	178.8	664.1	310.5

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujor Statistikor Nr. 248, Prishtinë, 2022, fq. 96.




Figura 7: Remitencat dhe kanalet e dërgimit para dhe gjatë pandemisë Covid19

Vështruar tabelën dhe grafikun lidhur me ecurinë e remitencave të dërguara në Kosovë në periudhën 2019-2021, përkatësisht periudhën e dërgimit të remitencave në Kosovë para pandemisë Covid19 dhe gjatë pandemisë Covid19, vërehet se përkundër masave të kufizimeve në ekonominë e vendeve të ndryshme, remitencat e dërguara në Kosovë kishin ecuri të rritjes në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 para fillimit të pandemisë Covid19.

Kështu që, në vitin 2019 para fillimit të pandemisë Covid19, remitencat e dërguara në Kosovë ishin 851.7 milionë euro, duke pasur gjatë periudhës së pandemisë Covid19 ecuri të rritjes remitencat e dërguara, kështu në vitin 2020 ishin në vlerë prej 980.0 milionë euro, ndërsa gjatë vitit 2021 në 1,1 miliardë euro.

5.Përfundimi-Konkluzionet dhe rekomandime

Në këtë punim analizohet ndikimi dhe efekti ekonomik i remitencave para dhe gjatë pandemisë Covid 19 në Kosovë. Padyshim vazhdon të mbetet rëndësia e remitencave të diasporës kosovare për ekonominë familjare në Kosovë, duke qenë burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe efekti i drejtpërdrejtë i tyre për konsumin e ekonomive familjare në Kosovë.

Duke pasur parasysh se Kosova ka nivel të ulët të prodhimit vendor dhe të rritjes ekonomike, si dhe normë të lartë të papunësisë, në këtë kuadër rëndësia dhe efekti i remitencave të diasporës kosovare ka qenë dhe mbetet i një rëndësie të veçantë për ekonominë familjare dhe ekonominë në përgjithësi në Kosovë.

Në kuadër të punimit dhe analiza që kemi bërë lidhur me ndikimin dhe efektin ekonomik të remitencave para dhe gjatë pandemisë Covid19 në Kosovë, paraqesim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet:

- Remitenecat e dërguara të diasporës paraqesin një burim të rëndësishëm të të ardhurave për ekonomitë familjare, duke pasur ndikim dhe efekte ekonomike gjithsesi në mirëqenien e familjeve në Kosovë.
- Remitenecat (dërgesat e parave nga diaspora) mbeten burim i rëndësishëm financiar dhe një element ndikues i rëndësishëm i kërkesës agregate, duke ndikuar në nivelin e konsumit dhe në standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.
- Diaspora paraqet një potencial të rëndësishëm për ekonomitë familjare dhe për ekonominë e Kosovës në përgjithësi.
- Remitenecat e dërguara në Kosovë duhet orientuar kryesisht në investime në sektorin privat në ekonomi.

Literatura:

1. Agjencia e statistikave të Kosovës (2013). Studimi mbi Remitenecat në Kosovë, Prishtinë.
2. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2021). Statistikat e llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008-2020, Prishtinë.
3. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2021). Statistikat e llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM4 2020, Prishtinë.
4. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2019). Statistikat Ekonomike, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM1, TM2, TM3, TM4, Prishtinë.
5. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2021). Statistikat Ekonomike, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM1, TM2, TM3, TM4 2020, Prishtinë.
6. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2021). Statistikat Sociale, Anketa e fuqisë punëtore, TM3-2020, Prishtinë.
7. Banka Qendrore e Kosovës (2021). Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike, Nr.35, Tremujore II/2021, Prishtinë.
8. Agjencia e Statistikave e Kosovës (2022). Statistikat e llogarive Kombëtare, Bruto Produkti Vendor TM1 2022, Prishtinë.
9. Banka Qendrore e Kosovës (2022). Buletini Mujor Statistikor Nr. 248, Prishtinë.
10. Banka Qendrore e Kosovës (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 226, Prishtinë.
11. Banka Qendrore e Kosovës (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 223, Prishtinë.
12. Banka Qendrore e Kosovës (2019). Buletini Mujor Statistikor Nr. 212, Prishtinë.
13. Banka Qendrore e Kosovës (2013). Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitancave në Kosovë, Prishtinë.
14. Limani, Musa. (2013). Makroekonomia, Prishtinë.
15. Limani, Musa. (2018). Ekonomia e Kosovës, Prishtinë.
16. USAID, UNDP (2010). Studimi i Remitencave në Kosovë 2010, Prishtinë.
17. Instituti Riinvest (2007). Diaspora dhe politikat e migracionit, Prishtinë.